



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

BULETINI

Shtator, 2008 Nr.20

NGA SEANCA SOLEMNE E KUVENDIT TË KOSOVËS **Shtetet e Bashkuara gjithmonë do të jenë afër popullit të Kosovës**



Komuniteti ndërkombëtar duhet ta kuptojë se lidhja mes Kosovës dhe Shteteve të Bashkuara është e fortë dhe gjithmonë do të mbetet e palëkundur

Pavarësimi i Kosovës dhe Kushtetuta e re do ta bëjnë shoqërinë tonë të lirë dhe sovranë, do të sigurojnë barazinë e plotë për të gjithë qytetarët e saj, pa asnjë dallim, duke e kthyer vendin tonë në një faktor paqeje e stabiliteti në rajon

Vizioni i Ahtisarit mund të mos jetë i përsosur, por është hap i mirë

Në luftën kundër krimit të organizuar Kosova do të ketë mbështetje të plotë nga ana e EULEX-it

Kapacitetet e Misionit të EULEX-it do të shtrihen në tërë territorin e Kosovës dhe për këtë nuk kemi asnjë dyshim Pritet ndihmë që drejtësia dhe gjyqësori të jenë në funksion të zbatimit të ligjit, sepse kemi qytetarë që janë të burgosur që 5 apo 6 vjet , pa asnjë vendim të gjyqësorit



Kryetari i Kuvendit të Republikës së Kosovës, Jakup Krasniqi, kishte sot një takim me shefin e Misionit të EULEX-it në Kosovë, z. Yves de Kermabon. Në fillim kryeparlamentari Krasniqi dha një pasqyrë të angazhimeve aktuale të Kuvendit të Kosovës, që nga Shpallja e Pavarësisë, aprovimi i Kushtetutës së Kosovës , si dhe aprovimi i ligjeve që dalin nga Pakoja e Ahtisarit. Në vijim, kryeparlamentari Krasniqi u shpreh se bashkë me EULEX-in do të shtrijmë autoritetin dhe veprimin e institucioneve në tërë territorin e Kosovës, sepse mungesa e një kontrolli bën që në pjesën veriore të vendit të ketë krim të organizuar. Krijimi i strukturave paralele po u krijojnë probleme qytetarëve tanë serbë, por edhe qytetarëve të tjerë. Duke folur për çështjet nga lëmi i drejtësisë dhe gjyqësorit në Kosovë, kryeparlamentari Krasniqi tha se ne presim ndihmën tuaj që drejtësia dhe gjyqësori të jenë në funksion të zbatimit të ligjit, sepse kemi qytetarë që janë të burgosur që 5 apo

6 vjet , pa asnjë vendim të gjyqësorit. Duke zgjidhur problemin e tyre në njëkohësisht do të ngremë edhe autoritetin e gjyqësorit. Pasi e përgëzoi kryeparlamentarin për punën e madhe që është bërë, shefi i Misionit të EULEX-it në Kosovë, z. Yves de Kermabon, theksoi se ne jemi këtu që t'ju ndihmojmë. Tashmë kur po bëhet rikonfigurimi i UNMIK-ut, krijohen mundësitë të vendosemi në tërë territorin e Kosovës , ndërsa jemi në konsultim të vazhdueshëm me PSPP-në. Kapacitetet e Misionit të EULEX-it do të shtrihen në tërë territorin e Kosovës dhe për këtë nuk kemi asnjë dyshim. Ne , theksoi më tutje z. Kermabon, do të sjellim në Kosovë edhe ekspertë gjyqësorë me njohuri e përvojë të madhe, që do të kontribuojnë në ecjen përpara të sistemit gjyqësor në Kosovë. Në këtë frymë, z. Kermabon premtoi se në luftën kundër krimit të organizuar Kosova do të ketë mbështetje të plotë nga ana e EULEX-it.



Përmbajtja:

Kryeparlamentari Krasniqi mori pjesë në Konventën e Partisë Demokratike në SHBA 7

Franca si kryesuese e BE-së mund të luajë rol për mbarëvajtjen e proceseve në Kosovë 11

Kosova tashmë ka krijuar një bazë të gjerë ligjesh, të cilat iu përmbahen standardeve më të larta evropiane e botërore12

Të mënjanohet ndikimi i politikës ditore në Administratën Tatimore të Kosovës 14

Republika e Kosovës është e orientuar jetësisht drejt Bashkimit Evropian 17

Redaksia:

Sherif Konjufca, Shefqet Rexhepi, Celal Ilyas, Edona Fetahu

Telefonat kontaktues:

038 / 211 186 / 211 949;
038 / 211 189; 044 / 127 921

Tel/Fax: 038 211 188

E-mail: media@assembly-kosova.org
Web faqja: www.assembly-kosova.org

Shtetet e Bashkuara gjithmonë do të jenë afër popullit të Kosovës

Komuniteti ndërkombëtar duhet ta kuptojë se lidhja mes Kosovës dhe Shteteve të Bashkuara është e fortë dhe gjithmonë do të mbetet e palëkundur Pavarësimi i Kosovës dhe Kushtetuta e re do ta bëjnë shoqërinë tonë të lirë dhe sovranë, do të sigurojnë barazinë e plotë për të gjithë qytetarët e saj, pa asnjë dallim, duke e kthyer vendin tonë në një faktor paqeje e stabiliteti në rajon Vizioni i Ahtisarit mund të mos jetë i përsosur, por është hap i mirë



Në shenjë nderimi ndaj meritave të kongresistit Eliot Engel për afirmimin e çështjes së Kosovës, Kuvendi i Republikës së Kosovës sot mbajti një seancë solemne, të cilën e ka hapur dhe e ka drejtuar kryetari i Kuvendit të Republikës së Kosovës, Jakup Krasniqi, i cili ka pohuar se Kuvendi ynë është sot shumë i nderuar dhe i privilegjuar ta ketë mysafir mikun e çmuar të Kosovës dhe popullit të saj, anëtarin e shquar të Kongresit të Shteteve të Bashkuara të Amerikës, zotin Eliot Engel. Në vijim kryeparlamentari Krasniqi tha: "Zoti Engel mirë se erdhët në Republikën e Kosovës, mirë se erdhët në organin

Seanca solemne e Kuvendit të Republikës së Kosovës është mbajtur për ta nderuar mikun e madh të Kosovës dhe të popullit të saj, kongresistin Eliot Engel, i cili iu ka drejtuar deputetëve me një fjalë rasti. Ishin të pranishëm president Sejdiu, kryeministri Thaçi, përfaqësuesi civil ndërkombëtar, Feith dhe mysafirë të tjerë të shumtë nga lëmi i arsimit, shkencës dhe fesë. Hyrja në sallë e kongresistit Engel, dalja në foltore dhe përfundimi i fjalimit i tij tepër domethënës për Kuvendin dhe popullin e Kosovës është pritur me brohoritje frenetike. Kryetari i Kuvendit të Republikës së Kosovës, Jakup Krasniqi, kishte një takim të veçantë me kongresistin Eliot Engel.

e saj më të lartë ligjvënës, në Kuvend. Duke ju përshëndetur Ju dhe bashkëpunëtorët që ju shoqërojnë, dëshiroj që në emër të Kuvendit të Kosovës t'ju falënderoj për vizitën që po na bëni në këto ditë solemne të shënimit të nëntëvjetorit të lirisë së Kosovës dhe të hyrjes në fuqi të Kushtetutës së Pavarësisë. Emri juaj zoti Engel është shumë i njohur dhe shumë i dashur gjithandej në Kosovë. Angazhimi i pandërprerë dhe shumë i gjatë e shumë i frytshëm për të drejtën e Kosovës dhe të popullit të saj, ju ka bërë një figurë emblematike veçanërisht të respektuar në mendjet dhe zemrat e qytetarëve të Kosovës.

Unë dua ta shfrytëzoj edhe këtë rast që më jepet për t'ju shprehur Juve dhe Shteteve të Bashkuara të Amerikës mirënjohjen e thellë dhe falënderimin e pafund, në emër të Kuvendit të Kosovës, të qytetarëve dhe timin personalisht për gjithë çfarë keni bërë për Kosovën e për qytetarët e saj. Pavarësia e Kosovës, e aspiruar nga populli i saj dhe e shpallur më 17 shkurt 2008, së cilës i keni kontribuar kaq shumë Ju zoti Engel dhe vendi juaj i mrekullueshëm, tashmë është njohur nga 42 vende anëtare të OKB dhe po mbështetet gjerësisht nga bashkësia ndërkombëtare. Pavarësimi i Kosovës dhe Kushtetuta e re do ta bëjnë shoqërinë tonë të lirë dhe sovranë, do të sigurojnë barazinë e plotë për të gjithë qytetarët e saj, pa asnjë dallim, duke e kthyer vendin tonë në një faktor paqeje e stabiliteti në rajon. Prioritete të shtetit tonë të ri, janë anëtarësimi në organizatat ndërkombëtare, duke përfshirë OKB, zhvillimi i gjithëmbarshtëm e ngritja e mirëqenies dhe integrimi rajonal e euroatlantik. Kosova është kthyer drejt të ardhmes së saj demokratike e evropiane, duke lënë pas historinë e saj të dhembshme. Ju sigurojmë që investimi juaj dhe ai ndërkombëtar për shtetin e Kosovës do të shkojë në dobi të gjithë qytetarëve të saj, në dobi të demokratizimit të vendit tonë dhe do t' i shërbejë paqes e sigurisë, jo vetëm në Kosovë, por në gjithë rajonin. Zoti Engel, duke ju falënderuar edhe njëherë, kam kënaqësinë t'ju ftoj t' i drejtoheni me një fjalë Kuvendit të Republikës së Kosovës”, theksoi kryeparlamentari Krasniqi.

Në vitin 1988 autoritetet serbe në Beograd më refuzuan vizën

Duke iu drejtuar të pranishmëve kongresisti Eliot L. Engeltha :” Është nder dhe kënaqësi t' i drejtohem Parlamentit të Kosovës së re dhe të pavarur. Kjo është hera e dytë që kam privilegjin e madh të flas në Parlamentin e Kosovës, por për shkak të pavarësisë kjo ka një kuptim më të madh për mua. Po ashtu sot jam këtu bashkë me kolegë time nga Dhomën e Përfaqësuesve, Jean Schmidt nga Ohajo, e cila po viziton Kosovën për herë të parë. E di se do ta mirëpritni atë sikurse që më keni mirëpritur mua gjithnjë. Siç e dini, unë kam qenë në Kosovë shumë herë më parë. Në vitin 1988, kur Kosova mundahej të ketë zgjedhje të lira, autoritetet në Beograd nuk i lejonin. Unë desha të vijë në Kosovë në atë kohë për të ndihmuar vëzhgimin dhe të tregoj përkrahjen time për zgjedhjet. Autoritetet Serbe në Beograd më refuzuan vizën dhe kur u mundova të hyj në Kosovë, më kthyen në kufirin me Maqedoninë. Javën që pasoi ne mbajtëm një tubim për Kosovën e pavarur para ndërtesës së Kombeve të Bashkuara në Neë York. Unë ju drejtova turmës prej afër 1000 njerëzve dhe thashë, “Javën e kaluar, unë u mundova të shkoj në Kosovë dhe Millosheviqi nuk më la të hyj. Por kam lajme për të, një ditë do të jemi në Kosovën e lirë dhe të pavarur dhe nuk do ta lejojmë atë të hyjë brenda.” E po, miqtë e mi, ne jemi në Kosovën e lirë dhe të pavarur dhe Millosheviqi, për krejt arsyt që veç i dini, nuk do të vijë të festojë lirinë me ne. Kur u deklarua pavarësia me 17 Shkurt, unë u preka aq shumë duke shikuar në televizion festimet në Prishtinë dhe Kosovë. Isha posaçërisht i prekur nga fakti që me mijëra shtetas tuaj e valëvitnin flamurin Amerikan në rrugët e Kosovës. Ditën tjetër kur ishte edhe ditëlindja ime, Shtetet e Bashkuara e pranuan Kosovën. Kjo ishte dhurata më e mirë që e kam fituar ndonjëherë për ditëlindje.

Dua t'ju siguroj se Shtetet e Bashkuara do të qëndrojnë gjithmonë krahas me popullin e Kosovës në dëshirën e tyre për të ndërtuar një shtet të fortë, të pavarur dhe një shoqëri të lirë. Shtetet e Bashkuara dhe Kosova kanë shumë gjëra të përbashkëta, përfshirë këtu edhe idealin për liri dhe demokraci. Dhe natyrisht ju siguroj personalisht se derisa unë vazhdoj të punoj në Kongresin e Shteteve të Bashkuara, do të mbaj në zemër interesat më të mirë të dy shteteve tona dhe do të siguroj se lidhjet mes dy shteteve tona do të jenë të forta dhe se Shtetet e Bashkuara do të japin krejt ndihmën e mundshme Kosovës.

Unë gjithnjë kam thënë se populli i Kosovës është miku më i mirë i Amerikës dhe qytetarët e Shteteve të Bashkuara të Amerikës janë miqtë më të mirë të Kosovës.

Siç e dini, Komuniteti Shqiptaro-Amerikan në SHBA ndihmon të forcohen lidhjet mes dy shteteve tona. Unë kam afër këtu shume prej tyre, duke përfshirë mikun tim të mirë Harry Bajraktari. Kosovës i nevojiten investime dhe komuniteti Shqiptaro Amerikan duhet ta udhëheq këtë. Harry dhe Rrustem Gecaj, që të dy të lindur në Kosovë, janë investitorët Amerikanë kryesorë në Kosovë, dhe të tjerët duhet t'u bashkohen. Qeveria e re e Kosovës duhet të bëjë çmos që të inkurajojë dhe shtyjë investimet përmes privatizimit dhe tatimit të volitshëm për biznese.

Ndërtimi i shtetit është qartazi një detyrë e vështirë. Kur rrite-sha në Nju York, lexoja për pa-

triotët Amerikan që formuan shtetin e ri. Njerëzit si: George Ëashington, John Adams, Benjamin Franklin, dhe Thomas Jefferson janë emrat që vazhdimisht përsëriten në librat e historisë së Amerikës.

Patriotë janë ata njerëz të Kosovës që kurrë nuk e humbën ëndrrën për pavarësi

Por, këtu në Kosovë kjo është gjenerata e patriotëve që janë duke barrur barrën e shtetformimit. Ne nuk na duhet të lexojmë për këta patriotë në libra historie. Patriotët jeni të gjithë ju. Patriotët janë njerëzit e ulur sot në parlament këtu në Prishtinë. Patriotë janë njerëzit e Kosovës që përjetuan tiraninë, diktaturën, diskriminimin, dhe shumë përlule tjera për vite të tëra. Patriotë janë ata që u kthyen në Kosovë në vitin 1999 dhe panë shtëpitë e tyre të djegura dhe të shkatërruara, dhe të cilët punuan shumë t'i rindërtojnë ato dhe të rindërtojnë bizneset e tyre. Patriotë janë ata njerëz të Kosovës që kurrë nuk e humbën ëndrrën për pavarësi, dhe vazhduan të besojnë se pavarësia mund të ndodh një ditë, edhe pse nganjëherë dukej se kurrë nuk do ndodh. Njerëzit e Kosovës janë të gjithë patriotë të cilët me veprat e tyre luajtën një rol të rëndësishëm në ringjalljen e Kosovës, duke e bërë të mundur që të ketë një shtet të ri demokratik dhe të pavarur.

Xhamitë, manastiret, kishat dhe të gjitha shtëpitë e lutjeve duhet të mbrohen

Mirëpo, aq sa jemi të lumtur në Kosovën e lirë dhe të pavarur, ka shumë sfida para jush. Shumë punë duhet të bëhet dhe puna e madhe ju pret. Ekonomia ka nevojë për

ndihmë. Institucionet demokratike duhet të forcohen. Korrupsioni duhet të zhduket. Papunësia duhet të zvogëlohet. Duhet krijuar më shumë vende pune. Sektori i energjisë ka nevojë të riparohet urgjentisht dhe të ketë një strategji urgjente vendimtare. Pastaj të gjithë njerëzit e këtij shteti duhet ta dinë se ka një të ardhme të ndritur në Kosovë jo vetëm për shumicën shqiptare por edhe për minoritetet gjithashtu.

Kosova duhet të jetë një demokraci shumë-etnike, me mbrojtje të drejtave të minoriteteve dhe religjioneve të minoriteteve. Xhamitë, manastiret, kishat dhe të gjitha shtëpitë e lutjeve duhet të mbrohen. Kosova duhet të jetë shembull për rajonin. Ne kurrë nuk duhet të keqtrajtojmë serbët dhe minoritetet tjera ashtu siç i keqtrajtonte Millosheviqi shqiptarët. Duke i hapur dyert e lirisë për të gjitha kombet e kësaj toke, ju do të vendosni shtetin tuaj të ri në radhët e demokracive perëndimore dhe do të keni vend krahas Shteteve të Bashkuara dhe fqinjëve tuaj në Evropë.

Sot, shteti juaj udhëhiqet nga njerëz të aftë. E di se ju, kryeministër Thaçi, dhe të tjerët keni luftuar shumë gjatë viteve të vështira për të larguar barrën e represionit ndaj popullit të Kosovës. Ata që i morën armët në mënyrë që kombi i tyre një ditë të jetë i lirë janë heronj të këtij vendi, ata që nuk pranonin të konsideroheshin si qytetar të rendit të dytë.

Zoti Kryeministër, unë përkulem para jush dhe gjithë atyre luftëtarëve të guximshëm që luftuan në atë betejë.

Liria nuk vjen lehtë. Populli i Kosovës ka vuajtur shumë padrejtësi për shumë vite të mundimshme. Shumë familje sikur Jasharajt, Haradinajt, dhe shumë të tjera, kanë sakrifikuar në mënyrë që një ditë populli të jetë i lirë.

Dua të përsëritet shumë miq të mi në Parlament. President Sejdiu, është gjithnjë kënaqësi t'ju shoh.

Ministri i Punëve Të Jashtme Hysoni, më kujtohet para 10 vitesh kur punoja në Zyrën time si studiues në një program trajnimi. Gjithnjë bëj shaka dhe them se njerëzit që dalin nga zyra ime përparojnë dhe shkojnë tutje dhe Skënder, kjo vlen gjithsesi për ju.

Do t'isha i pakujdesshëm nëse nuk e përmend njeriun i cili ishte udhëheqës i juaj në kohërat më të vështira dhe të errëta dhe ishte instrumental duke siguruar se Kosova një ditë do të jetë shtet i pavarur dhe i lirë. Kisha nderin ta quaja mikun tim për vite të tëra dhe isha i pikëlluar kur mora pjesë në varrimin e tij në Prishtinë para disa vitesh. Natyrisht se po flas për dr. Ibrahim Rugovën i cili u sakrifikua aq shumë për popullin e tij. Është shumë tragjike dhe ironike që ai nuk e përjetoi ta shohë Kosovën plotësisht të lirë. Por themelin që ai e shtroi ishte shumë i fortë. Është themel mbi të cilin ne të gjithë jemi duke ndërtuar.

Demokratët dhe Republikanët kanë të përbashkët përkushtimin ndaj këtij rajoni

Mirëpo, tani jemi në vitin 2008 – vit i pavarësisë dhe tani jemi në prag të një fillimi të ri. Më shumë se 40 shtete kanë njohur Kosovën dhe shpresoj dhe besoj se edhe shtete tjera do ta bëjnë këtë gjë.

Mbrëmë, kisha nderin dhe privilegjin të marr pjesë në ceremoninë e mirëpritjes së hyrjes në fuqi të kushtetutës suaj të re. Po ashtu mësova se ky Parlament do të kalojë legjislaturën kyçe që do ta formojë Kosovën si shtet ku zbatimi i ligjit është me rëndësi kapitale. Miqtë e mi, demokracia po zë rrënjë të forta. Plani i Ahtisarit për mendimin tim, ofron një kornizë të mirë ku mund të ndërtohet republika juaj e re. Vizioni i Ahtisarit mund të mos jetë i përsosur, por është hap i mirë. Dëshiroj

ta lavdërojë ish - presidentin e Finlandës Marti Ahtisarin, për kontributin e tij të rëndësishëm, ndjenjën e tij për drejtësi, dhe kuptimin e tij për realitetin praktik me të cilin ballafaqohet ky rajon. Puna e tij e palodhshme ka ndihmuar popullin e Kosovës që të arrijë në këtë ditë. Shumë udhëheqës nga bota kanë qëndruar pranë vendit tuaj në kërkesën për pavarësi. Presidenti Bill Clinton e mposhti spastrimin etnik duke autorizuar bombardimin e ushtrisë së terrorit dhe represionit të Millosheviqit. Më kujtohet kur pata folur me President Klintonin në Ëashington gjatë kohës së spastrimit etnik dhe i pata thënë se ne nuk duhet ta lejojmë këtë të ndodhë; ne duhet të bëjmë diçka. Presidenti më është përgjigjur “Unë nuk do ta lejoj këtë të ndodhë.” Kjo edhe përshtatet se njëra prej rrugëve në Prishtinë quhet “Bulevardi Bill Clinton”. Unë po ashtu më duhet t’ju tregoj se ishte nder për mua të kem një rrugë në Pejë: “Bulevardi Kongresisti Eliot Engel”. Jam i lumtur që Presidenti Bush ka vazhduar politikën e njëjta për miqësi dhe përkrahje ndaj popullit të Kosovës. Politika e Shteteve të Bashkuara është vërtet jo partiake, dhe më vjen mirë që kolegja ime republikane Jean Smidt kongresiste nga Ohajo është këtu me mua sot. Së bashku ne demonstrojmë se Demokratët dhe Republikanët kanë të përbashkët përkushtimin ndaj këtij rajoni. Unë besoj fuqishëm se përparimi ndodh vetëm atëherë kur Shtetet e Bashkuara angazhohen intensivisht në Evropën Jugore. Udhëheqësit Amerikan kanë qene një forcë shtytëse këtu në Kosovë dhe përgjatë Ballkanit dhe ne nuk duhet të ikim nga sfidat që na presin. Kushdo që do të zgjedhet Kryetar i Shteteve të Bashkuara këtë vit duhet të vazhdojë politikën e angazhimit dhe lidhjet e ngushta me popullin e Kosovës. Ju siguroj se nuk do të lë asnjë gur pa

rrotulluar për të siguruar se Presidenti i Shteteve të Bashkuara do të forcojë miqësinë me Kosovën dhe do ta sjellë miqësinë tonë në një epokë të re. Por, komuniteti ndërkombëtar duhet ta kuptoj se lidhja mes Kosovës dhe Shteteve të Bashkuara është e fortë dhe gjithmonë do të mbetet e palëkundur. Miqësia jonë është solide dhe përkushtimi jonë për demokracinë tuaj është i vendosur. Po ashtu, bota duhet ta dijë se Republika e re e Kosovës është e përjetshme. Ajo i është bashkangjitur shteteve që duan lirinë dhe qëndron me krenari në rajonin e shteteve rishtas të pavarura me synim në ardhmërinë Euro Atlantike. Sipas meje, mendoj se Kosova një ditë to t’i bashkohet Shqipërisë, Kroacisë dhe Maqedonisë gjithashtu në NATO dhe në Bashkimin Evropian. Më lejoni të komentoj po ashtu edhe për një çështje madhore të ditës. Përderisa po qëndroj këtu para jush sot, bashkësia ndërkombëtare po vendos se kur dhe si do të bëj tranzicionin prej Kombeve të Bashkuara në Bashkimin Evropian në Kosovë. Derisa ky është një vendim që do të merret nga të tjerët, porosia është e qartë. Koha e OKB-së për të udhëhequr praninë ndërkombëtare në Kosovë ka përfunduar. Ne nuk duhet të lejomë kundërshtuesit në Moskë, Beograd, dhe gjëkundi të bllokojnë përparimin e Kosovës dhe të krijojnë destabilitet. Sekretari Gjeneral duhet të përshpejtojë tranzicionin dhe duhet të lejojë misionin e EULEX-it të fillojë operimet e plota sa më shpejtë që është e mundur. Ndërrimi nuk ka të bëjë

vetëm prej UNMIK në EULEX. Tranzicioni i vërtetë është për qeverinë e Kosovës. Ne pamë se gjatë viteve të UNMIK-ut zvarritja e dorëzimit të kompetencave të udhëheqësit tuaj të zgjedhur, ka parandaluar popullin e Kosovës për të jetuar jetët e tyre dhe ka shkaktuar pakënaqësi. Transferimi i shumicës së kompetencave ka ndodhur në fakt në vitin e fundit, por me planin e Ahtisarit, unë shpresoj se do të shpejtojë ditën kur procesi i Kosovës kompletohet dhe Kosova bëhet plotësisht sovranë.

Dhe në fund, dëshiroj që të falënderoj veçanërisht Forcat e Armatosura të Shteteve të Bashkuara me bazë në Bondsteel. Dje unë dhe Jean Schmidt vizitua ushtarët amerikanë dhe u treguam atyre sa shumë e çojmë shërbimin e tyre. Ata kanë ndihmuar të ofrojnë siguri për krejt popullin e Kosovës pa dallim kombi dhe kanë përmëshur vlerat që Shtetet e Bashkuara i synojnë në tërë botën. Ata kanë falënderimin tim më të thellë dhe falënderimin e një kombi.

Sërish dëshiroj t’ju tregoj se ishte nder i madh për mua të flas në Parlamentin e Kosovës së lirë dhe të pavarur. Më kujtohet kur hyra në Kongres para 20 viteve dhe nocioni që Kosova të bëhet tokë sovranë ishte një ëndërr. Atëherë kapeshim për kashtë duke u munduar që të luftonim represionin e Millosheviqit. Por sot, ëndrra u bë realitet dhe drejtësia u arrit. Liria juaj është në të mirë të komunitetit të kombeve dhe shpëtimi juaj është një provë e njerëzimit. Ju dëshiroj gjithë të mirat derisa hyni në këtë udhëtim madhështor dhe pres me padurim t’ju ndihmoj në ditët në vijim”, theksoi Eliot Engël.

KRYETARI I KUVENDIT TË KOSOVËS NË VIZITË
ZYRTARE NË SHBA

Mbështetje e fuqishme e SHBA-ve për Kosovën

Kryeparlamentari Krasniqi mori pjesë në Konventën e Partisë Demokratike në SHBA

Takime të veçanta me zonjat Pellosi dhe Ollbrajt , si dhe me homologë nga disa shtete të botës

Bëhen përpjekje të mëdha për integrimin e pakicave, posaçërisht të serbëve, në institucionet e Kosovës



Pamje nga takimi i kryeparlamentarit Jakup Krasniqi dhe anëtarit të Kryesisë së Parlamentit të Kosovës Sllobodan Petroviq, me zëvendës ndihmës sekretarin amerikan të Departamentit të Shtetit, Stuart Jones

Gjendja e krijuar në pjesën veriore të Kosovës u konvenon vetë grupeve kriminale dhe jo qytetarëve të Kosovës

Krahas mbështetjes politike dhe ekonomike, SHBA-të ta mbështesin fuqishëm edhe Forcën e Sigurisë së Kosovës

Kryetari i Kuvendit të Kosovës, Jakup Krasniqi, bashkë me anëtarin e Kryesisë, Sllobodan Petroviq, ishte në një vizitë zyrtare në SHBA. Në kuadër të kësaj vizite

ky delegacion prej 24 deri më 28 gusht mori pjesë në Konventën e Partisë Demokratike të SHBA-së, e cila u mbajt në Denver-Kolorado.

Kryeparlamentari Krasniqi , në kuadër të aktiviteteve të tij, kishte takime edhe me kryetaren e Kongresit Amerikan zonjën Nensi Pellosi, si dhe me ish-sekretaren e shtetit Medlin Ollbrajt . Takime të veçanta kryeparlamentari Krasniqi pati

edhe me kryetarët e parlamenteve të Bolivisë, Bosnjë-Hercegovinës, Bullgarisë, Gjeorgjisë, Nigerisë, Ekuadorit, Guines Bisao, Haitit , Jordanisë, Liberisë dhe të Parlamentit të shtetit Niger . Në këto takime kryeparlamentari Krasniqi i njoftoi homologët me proceset aktuale politike në Kosovë, duke shtruar edhe kërkesën për njohje të shtetit të pavarur të Kosovës nga ana e këtyre shteteve.

Përpjekjet e Serbisë ndikojnë në destabilizimin e proceseve

Një takim mjaft miqësor kryeparlamentari Krasniqi kishte me ambasadorin e Republikës së Haitit në Uashington, z. Rajmon Jozef. Në fillim kryeparlamentari Krasniqi e njohu ambasadorin e Haitit lidhur me rrjedhat politike dhe ekonomike në Kosovë, që nga 17 shkurti e deri më sot, duke u përqendruar sidomos në angazhimet e Kuvendi të Kosovës dhe Qeverisë për integrimin e pakicave në jetën e gjithëmbarshme shoqërore e ekonomike në Kosovë, posaçërisht të minoritetit serb. Kryetari i Kuvendit të Kosovës, Jakup Krasniqi theksoi me këtë rast se Pakoja e Ahtisarit, megjithëse është e dhimbshme, ne e kemi pranuar për të vetmen arsye, që të lëmë të kaluarën prapa, për hir të prosperitetit të së ardhmes.

Z. Rajmon Jozef në këtë takim theksoi se edhe Qeveria e Haitit është duke shqyrtuar mundësitë për njohjen e pavarësisë së Kosovës. Ai në vijim tha se ju keni miq të mëdhenj në botë, siç është kongresisti amerikan, z. Eliot Engël.

Po ashtu, një takim shumë të veçantë e shumë miqësor kryeparlamentari Krasniqi pati edhe me ambasadorin e Nigerit në Uashington, Toure Magiu, të cilën gjithashtu e njoftoi me rrjedhat aktuale në Kosovë, si dhe me përpjekjet që bëhen për integrimin e minoritetit serb në institucionet kosovare. Lidhur me këtë, kryeparlamentari Krasniqi, theksoi se Qeveria e Serbisë me politiken e vet destruktive, po përpiket që

nëpërmjet strukturave të saj të destabilizojë Kosovën. Këto përpjekje të Serbisë janë, jo vetëm kundër stabilitetit të Kosovës, por ato janë edhe antirajonale e antievropiane, sepse ndikojnë në destabilitetin e proceseve që zhvillohen në Evropë. Z. Jakup Krasniqi me këtë rast i dhuroi zonjës Toure Magiu një kopje të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke kërkuar nga ajo që edhe vendi i saj të njohë pavarësinë e Kosovës, sepse në këtë mënyrë do të ndikohet edhe në stabilizimin në Evropë. Zonja Toure e falënderoi për këto njoftime kryeparlamentarin, duke theksuar se ajo do ta njohë Qeverinë dhe kryetarin e vendit të saj me zhvillimet politike në Kosovë.

Kryetari i Kuvendit të Kosovës, Jakup Krasniqi, kishte një takim edhe me presidentin e NDI-së dhe drejtorin e këtij institucioni për Evropën Qendrore, përkatësisht z. Kenneth Vollack dhe z. Robert Benjamin. Gjithashtu, kryeparlamentari Krasniqi në kuadër të pjesëmarrjes në Konventën e Partisë Demokratike të SHBA-së, pati takime edhe me ish-ministrin gjerman Joshka Fisher, ambasadorin fuqplotë të Turqisë dhe me ambasadorin e Malit të Zi në Uashington.

Takim me kongresistët amerikanë Engel dhe Pomeroy

Gjatë vizitës në SHBA, kryetari i Kuvendit të Kosovës, Jakup Krasniqi, i shoqëruar nga anëtari i Kryesisë, Slobodan Petroviq, ka pasur një takim prej dyorësh me dy kongresistët e njohur amerikanë: Eliot Engel dhe Earl Pomeroy.

Kryeparlamentari Krasniqi, pasi i ka falënderuar SHBA-të për

mbështetjen e madhe për Kosovën dhe popullin e saj, ka folur për zhvillimet në Kosovë dhe ka prezantuar të arriturat e vendit pas 17 shkurtit. Ai ka theksuar përkushtimin e institucioneve të Kosovës për zhvillim të përsheptuar dhe të papenguar për të gjithë qytetarët e Kosovës, e sidomos për integrimin e qytetarëve të komunitetit serb. Me gjithë punën e madhe në këtë drejtim, nuk jemi të kënaqur me rezultatet, pikërisht për shkak të obstrukcioneve të regjimit të Beogradit dhe nxitjes së banorëve serbë të Kosovës për të kundërshtuar institucionet vendit dhe ato ndërkombëtare në Kosovë, u ka thënë Krasniqi kongresistëve amerikanë, duke theksuar qëndrimin e palëkundur të Kuvendit dhe të institucioneve të tjera të Kosovës për të pasur sukses në integrimin e serbëve në shoqërinë demokratike të Kosovës. Me këtë rast kreu i Kuvendit të Kosovës ka kërkuar që krahas mbështetjes së politike dhe ekonomike, SHBA-të ta mbështesin fuqishëm edhe Forcën e Sigurisë së Kosovës.

Duke e marrë fjalën në këtë takim, anëtari i Kryesisë së Kuvendit të Kosovës, Slobodan Petroviq, i ka quajtur të papranueshme institucionet paralele serbe në Kosovë. Gjendja e krijuar në pjesën veriore të Kosovës u konvenon vetë grupeve kriminale dhe jo qytetarëve të Kosovës, ka pohuar Petroviq. Ai ka theksuar se institucionet e Kosovës po bëjnë ç'është e mundur për zhvillim dhe siguri të të gjitha komuniteteve dhe është zotuar se partia e tij do të angazhohet për realizimin e interesave të njëmendta të qytetarëve serbë të Kosovës

dhe për të jetuar lirshëm bashkë me komunitete e tjera. Kongresisti Eliot Engel ka theksuar se ai ka qenë dhe do të mbetet mik dhe mbështetës i pavarësisë së Kosovës. I tillë do të mbetem edhe për sa i përket mbështetjes së Kosovës në planin e zhvillimit ekonomik, politik dhe kulturor të vendit, pa dallim etnie dhe për të gjithë qytetarët e Kosovës. Edhe kongresisti, Earl Pomeroy, ka premtuar mbështetjen gjithëpërfshirëse për shtetin e ri të Kosovës dhe për popullin e saj.

EULEX - në tërë territorin e Kosovës

Në kuadër të vizitës në SHBA, kryetari i Kuvendit të Kosovës, Jakup Krasniqi, bashkë me anëtarin e Kryesisë së Kuvendit, Sllobodan Petroviqin, u pritën në një takim nga zëvendëshefja e SHBA-së në Misionin e OKB-së, ambasadorën Rozmari di Karlo. Me këtë rast kryetari i Kuvendit, Jakup Krasniqi, i bëri një rezymë proceseve aktuale politike në Kosovë. Në këtë frymë, ai theksoi se që nga 17 shkurti në Kosovë kanë ndodhur ndryshime të mëdha pozitive, sidomos në lëmin e legjislacionit, përkatësisht aprovimi i ligjeve nga Pakoja e Ahtisarit, pastaj të simboleve shtetërore të Kosovës etj. Tani është në proces rikonfigurimi i Misionit të OKB-së në Kosovë, ndërsa deri në tetor pritet që EULEX-i të shtrihet në tërë territorin e Kosovës. Siguria në Kosovë është stabile, pos në veri, ku nuk ka stabilitet ashtu si dëshirojmë. Me shtrirjen e EULEX-it në tërë territorin e

Kosovës, theksoi kryeparlamentari Krasniqi, presim që situata të stabilizohet edhe në veri.

Qëllimi i institucioneve të Kosovës, tha në vijim kryeparlamentari Krasniqi, është vazhdimi njohjes së pavarësisë së Kosovës edhe nga shtetet tjetra të botës dhe anëtarësimi në OKB. Përkitazi me çështjen e bisedave me Serbinë, ai theksoi se me Serbinë do të bisedojmë vetëm për çështje teknike. Serbia nuk është e gatshme të angazhohet për të mirën e serbëve të Kosovës, theksoi z. Krasniqi. Gjatë këtij takimi Sllobodan Petroviqi theksoi se kemi probleme me institucionet paralele që financohen nga Serbia. Ne presim që sa më parë kjo të ndërpritet dhe të fillojë procesi i decentralizimit. Për komunitetin serb në Kosovë problem është çështja e zhvillimit ekonomik, duke ditur se këtu mbretëron papunësi e madhe. Rozmari di Karlo falënderoi kryeparlamentarin Krasniqi dhe anëtarin e Kryesisë, Petroviq, për këtë vizitë, duke i përgëzuar institucionet e Kosovës për të arriturat e tyre. Gjithashtu, ajo përshëndeti edhe emërimin e ambasadorëve në OKB dhe në Uashington. Kryeparlamentari Krasniqi e falënderoi z. Di Karlo për tërë kontributin e saj në zhvillimet pozitive në Kosovë, si dhe e përgëzoi për postin e ri të saj në OKB. Kryeparlamentari Krasniqi është takuar edhe me komunitetin e shqiptarëve në SHBA.

Premtohet vazhdimi i mbështetjes së Kosovës dhe të institucioneve të saj

Në kuadër të vizitës në SHBA, kryetari i Kuvendit të Kosovës, Jakup Krasniqi, bashkë me anëtarin e Kryesisë së Kuvendit, Sllobodan Petroviqin, është pritur sot nga zëvendësndihmës sekretari amerikan i shtetit, Stuart Jones, me të cilin ka biseduar lidhur me situatën politike dhe ekonomike në Kosovë.

Kryeparlamentari Krasniqi, pasi e ka uruar z. Jones për detyrën e re, e ka njoftuar diplomatin e lartë amerikan për zhvillimet në Kosovë pas 17 shkurtit, kur Kuvendi i Kosovës shpalli pavarësinë e vendit. Ai ka folur për veprimet shtetformuese të Kosovës, si: miratimi i Kushtetutës, i simboleve shtetërore dhe i korpusit të ligjeve që burojnë nga Plani i Ahtisarit.

Krasniqi, duke falënderuar mbështetjen amerikane prej 400 milionë dollarësh në Konferencën e donatorëve për Kosovën, ka theksuar se ekonomia e Kosovës ka nevojë për mbështetje të bashkësisë ndërkombëtare në rrugën e saj të përtëritjes, duke shfaqur shpresën për mbështetjen ekonomike nga SHBA-të. Ndër përparësitë e Kosovës për tërheqjen e investitorëve të huaj Krasniqi ka përmendur resurset natyrore të Kosovës dhe fuqinë e lirë punëtore.

Zëvendësndihmës sekretari amerikan i shtetit, Stuart Jones, duke vlerësuar të arriturat e Kosovës në planin e forcimit të demokracisë dhe kontributin e saj për paqe e stabilitet në rajon, ka premtuar vazhdimin e mbështetjes së Kosovës dhe të institucioneve të saj.

Mesazhe mbështetjeje për Kosovën dhe për thelimin e bashkëpunimit ndërmjet dy parlamenteve

Ambasadori hungarez i ka sjell kreut të Kuvendit të Kosovës letrën e kryetares së Parlamentit të Hungarisë, dr.Katalin Szili

Hungaria do ta mbështesë Kosovën në zhvillimin e bujqësisë dhe të privatizimit, si dhe për rinovimin e objekteve historike dhe kulturore në Kosovë



Kryetari i Kuvendit të Republikës së Kosovës, Jakup Krasniqi, ka pritur sot ambasadorin e Ambasadës Hungareze në Prishtinë, Zoltan Imecz, me të cilin ka biseduar për bashkëpunimin ndërparlamentar dhe bashkëpunimin ekonomik ndërmjet Kosovës dhe Hungarisë. Kryeparlamentari Krasniqi e ka falënderuar ambasadorin Imecz për mbështetjen e Hungarisë për zhvillimin e proceseve në Kosovës dhe sidomos për njohjen e shpejtë të shtetit të pavarur të Kosovës. Ai e ka vlerësuar kontributin e Hungarisë, si vend i Bashkimit Evropian, për mbështetjen e Kosovës për një afirmim më të shpejtë ndërkombëtar dhe sidomos për zhvillim më të përshpejtuar ekonomik të vendit

tonë. Ambasadori hungarez në Prishtinë, Zoltan Imecz, i cili i ka sjell kreut të Kuvendit të Kosovës letrën e kryetares së Parlamentit të Hungarisë, dr.Katalin Szili, me mesazhe mbështetjeje për Kosovën dhe për thellimin e bashkëpunimit ndërmjet dy parlamenteve, ka theksuar se bashkëpunimi fillimisht do të shtrihet ndërmjet komisioneve parlamentare, duke u zgjeruar pastaj edhe me kontakte të tjera, deri edhe në këmbim vizitash të kryetarëve të dy parlamenteve . Ai ka pohuar vullnetin e Hungarisë për ta mbështetur Kosovën në zhvillimin e bujqësisë dhe të privatizimit, duke ofruar edhe projekte konkrete në këtë lëmë. Diplomati hungarez ka konfirmuar donacionin prej

400 mijë euro për zhvillimin e bujqësisë dhe rinovimin e objekteve historike dhe kulturore në Kosovë, si dhe po aq mjete financiare për përgatitjen e certifikatave të lindjes për qytetarët e Kosovës. Në bashkëpunim me Universitetin Qendror të Budapestit dhe SOROS-in, do të realizojmë edhe një projekt për trajnimin e kuadrit lëmesëm të Qeverisë së Kosovës dhe të OJQ-ve, ka pohuar Imecz.

Në funksion të mbarëvajtjes së bashkëpunimit, Ambasada e Hungarisë në Prishtinë do ta emërojë një përgjegjës për kontakte të rregullta me Kuvendin e Kosovës, të cilën nismë e ka mirëpritur kryeparlamentari Krasniqi.

PYETJE TË DEPUTETËVE QË NUK MORËN PËRGJIGJE

Deputeti i PDK-së, Naim Rrustemi ia ka shtruar këtë pyetje , ministres së Drejtësisë , z. Nekibe Kelmendi:”A është bërë dorëzimi i Burgut të Mitrovicës me instruksione apo dijeninë e ministres së Drejtësisë dhe se çka keni ndërmarrë deri më tani që të

kthehet autoriteti i institucioneve legjitime të Republikës , në institucionet e shërbimit korrektues (ndëshkues) të Kosovës, si pjesë e sistemit unik në Republikën tonë të përcaktuara me ligjet në fuqi?

Franca si kryesuese e BE-së mund të luajë rol për mbarëvajtjen e proceseve në Kosovë

Faktorët ndërkombëtarë, sidomos Bashkimi Evropian duhet të kenë qartësi më të madhe për sa i përket pranisë së dyfishtë ndërkombëtare (EULEX-UNMIK) në Kosovë, sepse ndryshe do të kemi ndeshje kompetencash ekzekutive



Kryetari i Komisionit për Punë të Jashtme i Kuvendit të Republikës së Kosovës, Sabri Hamiti, i shoqëruar nga zëvendëskryetari i komisionit, Xhavit Haliti, ka pasur sot një takim me delegacionin e Komisionit të Mbrojtjes në Asamblenë Kombëtare të Francës, i kryesuar nga Jean-Louis Bernard, me të cilin ka biseduar për vështrimin e Komisionit lidhur me zhvillimet në Kosovë, sidomos për sa i përket pranisë ndërkombëtare dhe ndeshjes së mundshme të kompetencave, nga njëra anë ndërmjet EULEX-it dhe UNMIK-ut dhe ndërmjet Administratës Ndërkombëtare dhe institucioneve të Kosovës, nga ana tjetër.

Faktorët ndërkombëtarë, sidomos Bashkimi Evropian duhet të kenë qartësi më të madhe për sa i përket pranisë së dyfishtë ndërkombëtare (EULEX-UNMIK) në Kosovë, sepse ndryshe do të kemi ndeshje kompetencash, u ka thënë Sabri Hamiti parlamentarëve francezë nga Komisioni i Mbrojtjes. Ne kemi miratuar një Kushtetutë, e cila është derivim i Planit të Ahtisarit, e cila parasheh praninë e EULEX-it në Kosovë, por jo edhe të UNMIK-ut, ka thënë Hamiti, i cili ka shprehur shqetësimin për konfliktin e kompetencave ekzekutive në trekëndëshin EULEX-Qeveri-UNMIK. Pajtimin eventual të Bashkimit Evropian për të mbaj-

tur EULEX-in nën ombrellën e UNMIK-ut, Hamiti e ka quajtur kompromis të panatyrshëm.

Duke e vlerësuar rolin që do të luajë Franca si kryesuese e BE-së për mbarëvajtjen e proceseve në Kosovë, kryetari i Komisionit për Punë të Jashtme i Kuvendit të Republikës së Kosovës ka kërkuar qartësim të BE-së për Ballkanin Perëndimor dhe Kosovën. Ndërkaq, sa i përket rolit të KFOR-it në Kosovë, Hamiti ka theksuar se ai duhet të ruajë kufijtë e jashtëm të Kosovës, ndërkaq hapësira brenda territorit tonë është çështje e integriteteve, ka sqaruar ai.

Kosova tashmë ka krijuar një bazë të gjerë ligjesh, të cilat iu përmbahen standardeve më të larta evropiane e botërore

Duke zbatuar politikat për kthim të të gjithë qytetarëve që duan të kthehen në Kosovë, institucionet do të sigurojnë klimën politike të përshtatshme, kushtet e nevojshme dhe fondet financiare për këtë qëllim



Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim i Kuvendit të Kosovës, i kryesuar nga Bojan Stojanović, kryetar i Komisionit, organizoi sot një tryezë të rrumbullakët me temë “Roli i Kuvendit në mbikëqyrjen e projekteve për kthim të komuniteteve”. Në këtë mbledhje mori pjesë edhe kryetari i Kuvendit të Kosovës, Jakup Krasniqi, si dhe ministri i Ministrisë për Komunitete dhe Kthim, Boban Stanković, si dhe përfaqësues nga Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, dhe të institucioneve ndërkombëtare, si: USAID, OSBE, UNDP, ICO etj. Duke iu drejtuar të pranishmëve kryeparlamentari Krasniqi theksoi se kthimi i gjithë të zhvendosurve në vatrat dhe pronat e tyre, është një nga prioritetet politike të Republikës së Kosovës. Tani pas pavarësisë së Kosovës dhe hyrjes në fuqi të Kushtetutës, institucionet tona obligohen akoma më shumë për t’u marrë me tërë seriozitetin dhe fuqishëm me këtë çështje sa të ndjeshme aq edhe të rëndësishme, jo vetëm në kuptimin humanitar, por edhe politik. Në vijim kryetari i Kuvendit të Kosovës tha se në Kosovë po ndërtojmë një shoqëri të lirë me qytetarë të lirë dhe të barabartë. Duke zbatuar politikat për kthim të të gjithë qytetarëve që duan të kthehen në Kosovë, institucionet do të sigurojnë klimën politike të

përshtatshme, kushtet e nevojshme dhe fondet financiare për këtë qëllim.

Lidhur me aktivitetet dhe projektet për kthim të të zhvendosurve dhe për integrimin e tyre në shoqërinë kosovare, foli edhe ministri Boban Stanković, i cili theksoi se jemi në rrugë të drejtë dhe kësaj rruge nuk do t’i shmangemi. Në këtë frymë kontribuon pajtimi ndërmjet shqiptarëve dhe serbëve, si dhe realizimi i projekteve për kthim të të zhvendosurve. Përmirësimin e gjendjes në Kosovë, që reflektohet pozitivisht në kthimin e të shpërngulurve, ai e mbështeti në faktin se që nga viti 2004 në Kosovë nuk kishte konflikte. Po kështu pozitivisht po ndikon edhe realizimi konkret i shumë projekteve që mundësojnë kthim dhe jetë më të mirë të serbëve. Në këtë vështrim ai përmendi edhe realizimin konkret të shumë projekte të Ministrisë për Komunitete dhe Kthim nga lëmi i ngritjes së objekteve të banimit dhe të infrastrukturës në vendbanimet serbe. Me këtë rast ai theksoi se edhe komunitetet tjera pakicë në Kosovë ballafaqohen me probleme, ndaj edhe ato duhet të ndihmohen. Qasje dominuese e diskutueseve ishte se është i nevojshëm një unitet i plotë i institucioneve dhe qytetarëve për krijimin e një klime sa më të mirë për të gjithë qytetarët, se duhet të bëhen përpjekje të vazhdueshme për integrim të të

gjitha pakicave në të gjitha poret e jetës shoqërore e ekonomike në Kosovë. Ky synim është i mundshëm të realizohet, derisa ekziston vullneti i qytetarëve dhe institucioneve, sidomos duke pasur parasysh se Kosova tashmë ka krijuar një bazë të gjerë ligjesh, të cilat iu përmbahen standardeve më të larta evropiane e botërore nga lëmi i demokratizimit të jetës dhe sigurimit të të gjitha të drejtave për të gjithë qytetarët pa dallim.

Mirëpo, përkundër kësaj qasjeje, nga disa pjesëmarrës, sidomos nga radhët e komuniteteve jo serbe, kishte dilema dhe mospajtime me punën e bërë deri tash në kthimin dhe integrimin e këtyre komuniteteve, duke u ankuar sidomos në gjendjen e vështirë sociale dhe të papunësisë, madje me tone më të nxehta, që herë - herë ngritnin paksa tensionin e ecurisë së tryezës. Megjithatë, dominoi mendimi se duhet të shkojmë nga gjërat që na bashkojnë, me një qëndrim të njëjtë për të gjithë qytetarët drejt një ardhmërie të përbashkët.

Disa diskutues u angazhuan edhe për një mbikëqyrje më të mirë gjatë realizimit të projekteve për kthim, për të mos lejuar shpërdorime të mjeteve financiare.

Rregullohet edhe çështja e legalizimit të armëve trofe dhe të atyre koleksioniste

Projektligji për armët përbën një nga prioritetet në fushën e sigurisë, duke ditur se në Kosovë ekziston një numër i madh armësh ilegale



Komisioni për Punë të Brendshme dhe Siguri i Kuvendit të Kosovës, i kryesuar nga Rustem Mustafa, kryetar i Komisionit, organizoi sot një dëgjim publik, në të cilin ishin ftuar përfaqësues të Ministrisë së Punëve të Brendshme të Kosovës, si sponsorues të këtij Projektligji, përfaqësues të UNDP-së, të shoqërisë civile etj. Si në fjalën e Rustem Mustafës, ashtu edhe të referuesit Shkumbin Demaliajt, u tha se ky Projektligj, i cili tashmë ka kaluar në leximin e parë në Kuvendin e Kosovës, është në procedurë të shqyrtimit dhe të amendamentimit në këtë Komision, duke synuar që të jetë një ligj sa më i mirë dhe i zbatueshëm në praktikë. Edhe

përfaqësuesit e Ministrisë së Punëve të Brendshme theksuan se ky projektligj përbën një nga prioritetet në fushën e sigurisë, duke ditur se në Kosovë ekziston një numër i madh armësh ilegale, pasi Kosova kishte një fazë lufte. Debatimi që pasoi ishte mjaft i gjerë dhe i frytshëm. Me këtë rast u theksua se me dispozita përshkruhen mjaft mirë çështja e legalizimit të armëve dhe e përdorimit të tyre. Legalizimi i armëve nuk konsiderohet si ndonjë rrezik, sepse ekzistojnë kriteret për legalizimin e tyre. Në këtë frymë u tha se disa armë nga lufta janë në muze, por me Projektligj rregullohet edhe çështja e legalizimit të armëve trofe

dhe të atyre koleksioniste. Armët mund të ruhen si svenire, por ato poseduesit nuk kanë të drejtë t' i eksportojnë. Në debat u përmend edhe fakti se jo të gjitha armët mund të legalizohen. Ndër vërejtjet e diskutueseve u zunë në gojë ato që kanë të bëjnë me kërkesën për një përkthim sa më adekuat të tekstit bazë në gjuhën shqipe me tekstet në gjuhën serbe dhe sidomos, në atë angleze, në mënyrë që termat në të tri gjuhët të korrespondojnë në mënyrë adekuate ndërmjet tyre. U dhanë propozime edhe për disa qartësime të disa dispozitave, sidomos kur është fjala për transportin e armëve.

Të mënjanohet ndikimi i politikës ditore në Administratën Tatimore të Kosovës

Ekspertë, përfaqësues të institucioneve dhe të grupeve të interesit debatojnë lidhur me Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 2004/48 për Administratën Tatimore dhe Procedurat



Në dëgjimin publik të organizuar nga Komisioni për Buxhet dhe Financa i Kuvendit të Kosovës, ekspertë financiarë dhe të politikave fiskale, përfaqësues të institucioneve dhe të grupeve të interesit, kanë debatuar sot lidhur me Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 2004/48 për Administratën Tatimore dhe Procedurat. Duke i falënderuar të pranishmit për pjesëmarrje në këtë dëgjim publik, kryesuesi i Komisioni për Buxhet dhe Financa, Gani Koci, ka vlerësuar si domosdoshmëri të kohës plotësimin e Ligjit për Administratën Tatimore dhe Procedurat, i miratuar më 2004 dhe i zbatuar që nga maji i viti 2005. Ai, ndërkaq, ka lavdëruar punën e bërë për ndryshimin ligjit, duke vlerësuar sidomos kriterin bazë gjatë hartimit të tij, për zgjerimin e bazës tatimore, krijimin e Njesisë së hetimit tatimor në Administratën Tatimore të Kosovës, mbajtjen e rregullt të librave të kontabilitetit etj. Pjesëmarrësit e shumtë në

diskutim kanë vlerësuar shumë çështje pozitive që rregullohen me këtë projektligj, si pajisjen e tatimpaguesve me numër të veçantë fiskal, evidencën më të përpiktë, etj, por kanë theksuar edhe zgjidhje në projektligj që nuk janë shumë stimuluese për bizneset, si : shkurtimi i afateve për pagesën e tatimeve dhe zgjatjen e afatit të rimbursimit të pagesave të tepërta, kamatat e larta për vonesat dhe për gabimet gjatë plotësimit të faturave. Përfaqësuesi i Fondit Monetar ndërkombëtar në Kosovë, Edgardo Ruggiero, ka theksuar se projektligji para se të miratohet përfundimisht në Kuvend duhet të harmonizohet me praktikën e mira ndërkombëtare në sferën e administratës tatimore, sidomos për sa i përket lehtësimit të përmbushjes së obligimeve dhe zvogëlimit të punëve joproduktive në administratën tatimore. Ai, në vërejtjet e tij me shkrim për Komisionin, ka theksuar praktikën e ndryshme ndërkombëtare për dënimet për mashtrim civil, që bëhen nga ad-

ministrata tatimore, pa pasur nevojë për autorizim nga gjykata dhe për dënimet e mashtrimit kriminal, që do të duhej të gjenin vend në këtë projektligj. Drejtoresha e Odës Ekonomike Amerikane në Kosovë, Mimoza Kusari, ka tërhequr vëmendjen se sipas zgjidhjeve që ofron projektligji, Kosova do të zërë vendin e dytë në rajon për nga shkalla e lartë e dënimeve për bizneset, që është destimuluese për zhvillim të shpejtë të vendit. Ajo ka vlerësuar se duhen dhënë sqarime më të detajuara për mbajtjen e librave të evidencës, ndërkaq ka theksuar se duhet të përcaktohet qartë se kur administrata tatimore mund të kërkojë kontrollin e llogarive bankare të tatimpaguesve, sepse ndryshe, ka tërhequr vërejtjen ajo, bizneset në Kosovë mund të ballafaqohen me kontrole të shpeshta dhe qëllimkëqija. Edhe përfaqësuesit e tjerë në debat nga Administrata Tatimore, BSPK-ja, Universiteti, shoqatat e bankave, të kontabilistëve etj. kanë dhënë propozime me vlerë, duke kërkuar që të mënjanohet ndikimi i politikës ditore në Administratën Tatimore të Kosovës. Vërejtjet, sugjerimet dhe propozimet e ndryshme të pjesëmarrësve, në këtë dëgjim publik, do t'i shërbejnë Komisionit për Buxhet dhe Financa t'i përgatisë amendamentet për këtë projektligj, të cilat do të shqyrtohen nga Kuvendi i Kosovës gjatë miratimit përfundimtar të ligjit.

KRYEPARLAMENTARI KRASNIQI UA DORËZOI KOPJEN E DEKLARATËS SË PAVARËSISË DREJTORËVE TË ARKIVAVE TË KOSOVËS DHE TË SHQIPËRISË

Sublimim gati njëqindvjeçar i përpjekjeve të popullit shqiptar për liri dhe pavarësi

Ky akt madhor i të sotmes dhe i të ardhmes së Kosovës do të ruhet në këto arkiva si një nga dokumentet më të çmuara të historisë së Kosovës

Kryetari i Kuvendit të Kosovës, Jakup Krasniqi, ua dorëzoi sot kopjen e Deklaratës së Pavarësisë, Arkivit të Kosovës dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave të Shqipërisë. Dorëzimi u bë në mënyrë solemne në ambientet e Bibliotekës Kombëtare të Kosovës. Solemnitetin e dorëzimit të Deklaratës së Pavarësisë së Kosovës e hapi drejtori i Arkivit të Kosovës, dr. Jusuf Osmani, i cili në fillim përshëndeti kryetarin e Kuvendit të Kosovës, i cili kishte ardhur të dorëzojë këtë akt madhor të së sotmes dhe të ardhmes së Kosovës. Pjesëmarrës në këtë solemnitet ishin edhe prof.dr. Nevila Nika, drejtore e përgjithshme e Arkivave të Shqipërisë, Vladimir Zhumer, drejtor i Drejtorisë së Arkivave të Sllovenisë, si dhe shumë pjesëmarrës të tjerë, vijues të seminarit që ishte organizuar nga Arkivi i Kosovës mbi arkivistikën. Në vijim Jusuf Osmani ia dha fjalën kryetarit të Kuvendit të Kosovës, Jakup Krasniqi. Duke i përshëndetur të pranishmit në emrin e tij dhe në emrin e Kuvendit të Republikës së Kosovës, kryetari i Kuvendit, Jakup Krasniqi, theksoi se akti i dorëzimit të Deklaratës së Pavarësisë dhe arkivimi i saj në Arkivin e Kosovës dhe në Arkivin e Shqipërisë është një akt i veçantë dhe dallon shumë nga dokumentet tjera që i ka arkivi dhe që arkivohen. Deklarata e Pavarësisë përmban në vetvete një sublimim gati



njëqindvjeçar të përpjekjeve të popullit shqiptar për liri dhe pavarësi. Do të thotë është një dokument që sublimon aspiratën e popullit shqiptar nga viti 1912 e këndej, është një dokument i rëndësishëm për të sotmen e Kosovës, është një dokument i rëndësishëm për qytetarët e Kosovës dhe sigurisht do të mbetet një dokument i rëndësishëm i arkivuar në këto arkiva edhe për të ardhmen e Kosovës dhe për shkencën e historisë, natyrisht edhe për arkivistikën. Është një akt që vërtet brezat do ta shfrytëzojnë dhe secili në mënyrën e vet do ta interpretojë, sepse Deklarata e Pavarësisë së Kosovës ka mundësi të shumta të interpretimit. Pas kësaj fjale, kryetari i Kuvendit të Kosovës ua dorëzoi nga një kopje të Deklaratës së Pavarësisë së Kosovës drejtorit të Arkivit të Kosovës, dr. Jusuf Osmani dhe drejtores së përgjithshme të Arkivave

të Shqipërisë, prof.dr. Nevila Nika. Të dy drejtorët e arkivave falënderuan kryetarin për këtë dokument madhor, të cilin u zotuan se do ta ruajnë si një nga dokumentet më të çmuara të historisë së Kosovës. Akti i dorëzimit të këtij dokumenti, tha Jusuf Osmani, Arkivit të Kosovës dhe Arkivit të Shqipërisë, dallon shumë nga dokumentet tjera, prandaj edhe do të ruhet e studiohet me kujdes të veçantë nga brezat e studuesve. Jam vërtet me fat, që pikërisht mua më ra hise që në emër të Arkivit të Shqipërisë të më dorëzohet Deklarata e Pavarësisë, sepse Kosova është edhe pjesë e historisë së familjes sime, duke ditur se gjyshi im ishte një nga pjesëtarët e Komitetit për Shpëtimin e Kosovës, theksoi me emocione të thella, prof. dr. Nevila Nika. Dorëzimi i Deklaratës, është një gjë e jashtëzakonshme për mua, tha Nika.

Është përgatitur Projektligji për Shërbimin Diplomatik të Kosovës

Ministrit i Punëve të Jashtme, Skender Hyseni, prezantoi para Komisionit sukseset dhe vështirësitë e ministrisë, të cilën e udhëheq, lidhur me afirmimin ndërkombëtar të Kosovës, njohjen e shtetit të Kosovës dhe krijimit të misioneve diplomatike të Kosovës në vende të ndryshme të botës



Një ditë para seancës plenare të Kuvendit të Kosovës, në të cilën do të paraqes interpelancë ministri i Punëve të Jashtme, Skender Hyseni (sipas kërkesës së Grupit Parlamentar të AKR-së), Komisioni Parlamentar për Punë të Jashtme i Kuvendit të Kosovës e ka ftuar sot ministrin Hyseni për të prezantuar sukseset dhe vështirësitë e ministrisë, të cilën e udhëheq, lidhur me afirmimin ndërkombëtar të Kosovës, njohjen e shtetit të Kosovës dhe krijim e misioneve diplomatike të Kosovës në vende të ndryshme të botës.

Ministri Hyseni pasi ka falënderuar për ftesën dhe ka shprehur gatishmërinë për kontakte të rregullta me Komisionin, ka elaboruar gjithë procedurën e krijimit të Ministrisë së Punëve të Jashtme, afatet e ngushta kohore për funksionalizimin e ministrisë, si dhe pengesat ligjore dhe financiare për një aktivitet më të dendur diplomatik, në funksion të nx-

itjes së njohjes së shtetit të Kosovës nga sa më shumë shtete, anëtare të OKB-së. Me gjithë këtë, ka theksuar Hyseni, Ministria ka bërë gjithë ç'është e mundur për afirmimin ndërkombëtar të Kosovës dhe ka arritur të marrë pjesë në takimet e rëndësishme ndërkombëtare, të cilat janë vlerësuar të rëndësishme për çështjen e Kosovës. Ai në këtë vështrim ka përmendur takimet e shumta me homologë të vendeve të tjera, si dhe rreth shtatëdhjetë takime me ambasadorë në vende të treta. Ministri ka theksuar se e kupton shqetësimin e qytetarëve për vonesë njohjeje nga vende të ndryshme të botës, sidomos të atyre nga Konferenca Islamike dhe Liga Arabe, por ka pohuar se ka lëvizje pozitive në këtë plan. Ai, ndërkaq, duke folur për nisimën serbe në Asamblenë e 63-të të OKB-së për Kosovën, ka theksuar se çfarëdo vendimi i Gjykatës ndërkombëtare të Hagës nuk do të prodhojë

veprime juridike, por gjithsesi mund të shkaktojë dëme anësore, të cilat duhet të përpiqemi t'i evitojmë.

Anëtarët e Komisionit e kanë falënderuar ministrin për sqarimet dhe i kanë shtruar pyetje të shumta lidhur me temën. Ka pasur, ndërkaq, qëndrime të ndryshme të anëtarëve të Komisionit për efektin e këtij takimi. Kështu derisa ndonjëri prej tyre e ka vlerësuar si praktikë të mirë takimin e tillë me ministrin para interpelancës së tij në seancën e Kuvendit, ndonjë anëtarë tjetër ka spikatur se më shumë se për vështirësitë e Ministrisë, kanë pritur që ministri të flasë për politikën e jashtme të Qeverisë dhe çka do të mund ta ndihmonte Komisioni Ministrinë e Jashtme. Dy anëtarë të Komisionit nga radhët e opozitës, madje, kanë vlerësuar se takimi i tillë në këtë kohë ishte i panevojshëm dhe se ka për qëllim ta ngulëfasë debatin pas paraqitjes së interpelancës.

Në përgjigjet e tij lidhur me krijimin e misioneve diplomatike, ministri Hyseni ka pohuar se është përgatitur Projektligji për Shërbimin Diplomatik të Kosovës, i cili është dorëzuar Qeverisë dhe se së shpejti pritet të shqyrtohet në Kuvend. Për mungesë të këtij ligji nuk janë zgjedhur ambasadorë të Kosovës, por të ngarkuar me punë, të përkohshëm, ka thënë Hyseni, i cili ka premtuar se në të ardhmen Komisioni do të ketë rastin të debatojë për tre emra për çdo vend ambasadori.

Republika e Kosovës është e orientuar jetësisht drejt Bashkimit Evropian

Memorandumin e parë të mirëkuptimit kryetari i Kuvendit të Kosovës, Jakup Krasniqi, e nënshkroi me ambasadorin gjerman, Hans-Dieter Steinbach dhe me drejtoreshën e Institutit Ndërkombëtar për Studime Krahasuese në Paris, zonja Zhoel Afisharr, kurse momerandumin e dytë me të ngarkuarën me punë në Ambasadën Franceze, Delphine Borione



Sot në hollin e Kuvendit të Republikës së Kosovës janë nënshkruar dy memorandume të mirëkuptimit në mes të Kuvendit të Kosovës, Institutit Ndërkombëtar për studime krahasuese të Parisit dhe Ambasadës Gjermane në Prishtinë. Këto marrëveshje të bashkëpunimit, të cilat janë në vazhden e Projektit për Mbështetje të Mëtejme të Kuvendit të Kosovës, i cili ka përfunduar misionin e tij dyvjeçar më 31 janar të këtij viti, i ka nënshkruar kryetari i Kuvendit, Jakup Krasniqi: të parin me ambasadorin gjerman në Prishtinë, Hans-Dieter Steinbach dhe me drejtoreshën e Institutit Ndërkombëtar për Studime Krahasuese në Paris, znj. Zhoel Afisharr, kurse të dytin me të ngarkuarën me punë në Ambasadën Franceze, Delphine Borione. Kryetari i Kuvendit të Kosovës, Jakup Krasniqi, duke e

marrë fjalën pas nënshkrimit të këtyre memorandumeve, ka theksuar se vazhdimi i ndihmës dhe bashkëpunimi bilateral midis parlamenteve tona, tashti pas një realiteti të ri, të krijuar me pavarësinë e Kosovës dhe me njohjen ndërkombëtare të saj, ka domethënie të madhe për Kuvendin dhe për Kosovën në përgjithësi.

Duke qenë thellësisht mirënjohëse për ndihmën e këtyre vendeve dhe të bashkësisë ndërkombëtare, Kosova është e përkushtuar në ngritjen në nivele të reja të miqësisë dhe të bashkëpunimit tonë.

„Republika e Kosovës është e orientuar jetësisht drejt Bashkimit Evropian dhe integriteteve euroatlantike, prandaj këto ndihma i vlerësojmë si investim në demoktazimin, zhvillimin dhe shpejtimin e proceseve integruese“, ka theksuar Krasniqi.

Ambasadori gjerman në Prishtinë, Hans-Dieter Steinbach, duke e përshëndetur nënshkrimin e këtyre marrëveshjeve të bashkëpunimit, ka spikatur mbështetjen e vazhdueshme të shtetit gjerman për mbarëvajtjen e proceseve në Kosovë, sidomos të ndihmës së ekspertëve për legjislacion të përparuar, por ka përmendur edhe investimet gjermane në vendet e Evropës juglindore.

E ngarkuara me punë në Ambasadën Franceze, Delphine Borione, marrëveshjen e sotme e ka quajtur një gur të vogël shtesë në ngritjen cilësore të Kuvendit, por që është tepër i rëndësishëm për institucionet e Kosovës. Ajo ndërkaq, e ka falënderuar kryeparlamentarin Krasniqi për përkushtimin e tij që të realizohet ky projekt.

Pritet që gjatë muajve të ardhshëm në Kuvendin e Kosovës të vijjnë ekspertë të sektorëve të ndryshëm të administratës, të cilat do të angazhohen për mbikëqyrjen dhe zbatimin e rregulloreve, ngritjen e mëtejme profesionale të anëtarëve të parlamentit dhe këshilltarëve ligjorë, si dhe për perfeksionimin e punës së administratës së Kuvendit. Vlerësohet që ky angazhim do të jetë një kontribut i rëndësishëm për sigurimin e standardeve evropiane në reformat e administratës së legjislativit të Kosovës.

Deklarata ofron tetë objektiva të realizueshme, të vendosura brenda afateve kohore

Institucionet e Kosovës, pra edhe Kuvendi, do të shqyrtojnë dhe shfrytëzojnë të gjitha mundësitë e bashkëpunimit dhe të përfitimit nga përkrahja që rezulton nga Deklarata e Mileniumit



Sot në Kuvendin e Republikës së Kosovës, në prani të deputetëve, të musafëve të shumtë dhe përfaqësuesve të medieve është mbajtur ceremonia e përirimit të monitorit të Objektivave Zhvillimore të Mijëvjeçarit.

Shiritin e përirimit e kanë tërhequr kryetari i Kuvendit të Republikës së Kosovës, Jakup Krasniqi dhe koordinatori i agjencive të OKB-së në Kosovë, Frode Muring.

Kuvendi i Republikës së Kosovës po tregon përkushtim të thellë në drejtim të bërjes së pavarësisë edhe nëpërmjet të një realiteti të ri zhvillimor, që do të lehtësohet nga Objektivat Zhvillimore të Mileniumit, ka theksuar kryeparlamentari Krasniqi në fjalën e tij të rastit. Duke shprehur keqardhje pse Kosova për arsye të statusit politik, nuk është përfshirë në nxjerrjen e Deklaratës së Asamblesë së Kombeve të Bashkuara për Objektivat e Mileniumit në Samitin e vitit 2000, Krasniqi ka theksuar se me ndihmën dhe bashkëpunimin me institucionet ndërkombëtare, si Ekipi i

Organizatave të Kombeve të Bashkuara në Kosovë, Kuvendi ynë do të angazhohet në ndërmarrjen e veprimeve për të ngritur cilësinë e jetesës për secilin qytetar pa asnjë bazë dallimi në Kosovë.

Institucionet e Kosovës, pra edhe Kuvendi, do të shqyrtojnë dhe shfrytëzojnë të gjitha mundësitë e bashkëpunimit dhe të përfitimit nga përkrahja që rezulton nga Deklarata e Mileniumit (teknike, informative, këshilluese dhe financiare), nëpërmjet të cilave mund të shtyjme agjendën tonë për një Kosovë me prosperitet dhe mirëqenie më të madhe, ka vënë në pah Krasniqi, duke premtuar se Kuvendi i Kosovës, nëpërmjet të një rezolute, do ta aprovojë së shpejti Deklaratën për Objektivat e Mileniumit.

Koordinatori i agjencive të OKB-së në Kosovë, Frode Muring, duke iu drejtuar të pranishmëve, këtë ngjarje e ka konsideruar si një hap përpara drejt të nesërme më të mirë të Kosovës. Duke e përkujtuar miratimin e Deklaratës së

Mijëvjeçarit, këtu e tetë vjet më parë, ai ka theksuar se kjo deklaratë thërret për “përgjegjësi kolektive të qeverive në përkushtimin e tyre drejt arritjes së zhvillimit njerëzor për të gjithë njerëzit anë e mbanë globit”. Deklarata, ka thënë Muring, ofron tetë objektiva të realizueshme, të vendosura brenda afateve kohore dhe në një gjuhë të kuptueshme, si dhe siguron tetëmbëdhjetë caqe dhe dyzet e tetë indikatorë, si bazë përcjelleje dhe vlerësimi të punës dhe të rezultateve të arritura. Ai pastaj ka përshkruar gjendjen aktuale aspak të mirë për shumë fëmijë skamnorë dhe nëna me vështirësi jete për vete dhe familjen, sëmundjet ngjithëse etj, prandaj nuk kemi kohë për të humbur, ka përfunduar Muring.

Në vazhdim për të pranishmit është shfaqur filmi i shkurtër “Kosova Minaturë”, kurse Nora Sahatçiu ka prezantuar ueb-faqet në të cilat të interesuarit mund të gjejnë materiale për Objektivat Zhvillimore të Mijëvjeçarit. Me këtë rast, në hollin e Kuvendit, ku është mbajtur ceremonia janë prezantuar broshura, fletëpalosje dhe materiale të tjera, të cilat afirmojnë OZHM-të. Kryeparlamentari Krasniqi para ceremonisë së përirimit kishte organizuar një pritje për koordinatoren e agjencive të OKB-së në Kosovë, Frode Muring, kurse pas saj Krasniqi dhe Muring u janë përgjigjur interesimeve të gazetarëve për gjasat e përmbushjes në Kosovë (deri më 2015) të Objektivat Zhvillimore të Mijëvjeçarit.

Kosova do të bëhet një vend i mirë jete për të gjithë

Përfaqësues të agjencive të OKB-së në Kosovë, të shoqërisë civile dhe deputetë të Kuvendit të Kosovës shqyrtuan Objektivat Zhvillimore të Mijëvjeçarit, aktivitetet e institucioneve të vendit për përmbushjen e këtyre objektivave, si dhe i kontribua draftimit të Rezolutës mbi Objektivat Zhvillimore të Mijëvjeçarit



Në një takim pune të palëve të interesit lidhur me përmbushjen nga Kosova të Objektivat Zhvillimore të Mijëvjeçarit, në të cilën merrnin pjesë përfaqësues të agjencive të OKB-së në Kosovës, përfaqësues të shoqërisë civile dhe deputetë të Kuvendit të Kosovës, u shqyrtuan sot mundësitë dhe aktivitetet e institucioneve të vendit, të shoqërisë civile dhe të qytetarëve për përmbushjen e këtyre objektivave, si dhe u kontribua për draftimin e Rezolutës mbi Objektivat Zhvillimore të Mijëvjeçarit, e cila parashihet të miratohet me 17 tetor të këtij viti. Takimi në Prishtinë mbahej në të njëjtën kohë me samitin e nivelit të lartë të OKB-së në New York, po për OZhM-të.

Deklarata mbi Objektivat Zhvillimore të Mijëvjeçarit (OZhM), e njohur si plan prej tetë objektivave synon të:

- Zhdukë varfërinë e skajshme dhe urinë,
- Arrijë edukimin fillor të

përgjithshëm,

- Promovojë barazinë gjinore dhe fuqizojë gruan,
 - Reduktojë mortalitetin e fëmijëve,
 - Përmirësojë shëndetin e nënave,
 - Luftojë HIV/AIDS,
 - Tuberkulozin dhe sëmundjet tjera,
 - Sigurojë qëndrueshmërinë e ambientit dhe të
 - Zhvillojë partneritetin global.
- Shefi i kabinetit dhe këshilltar i lartë i kryetarit të Kuvendit të Kosovës, Mehmet Hajrizi, duke e përshëndetur punën e këtij seminari, ka theksuar përkushtimin e Kuvendit të Kosovës për përmbushjen e Objektivat Zhvillimore të Mijëvjeçarit dhe miratimin e një rezolute për mbështetjen e Deklaratës së OKB-së për OZhM-të. Me këtë rast Hajrizi tha: “Objektivat Zhvillimore të Mijëvjeçarit do të hapin rrugën drejt mirëqenies së gjithë popullit të Kosovës, në të

njëjtën kohë edhe duke na afruar me standardet evropiane”, ndërkaq është shprehur optimist se Kuvendi i Kosovës, i përkrahur nga OKB-ja në Kosovë, do të përshpejtojë aktivitetet për të arritur OZhM-të dhe të sigurojë mirëqenien e të gjithë njerëzve në Kosovë.

Drejtori i UNDP-së për Kosovën, Maurice Dewulf, theksoi se 7 shkurti i këtij viti ka qenë ditë e shënuar, sepse atë ditë është nënshkruar marrëveshja për partneritet afatgjatë me Kuvendin e Kosovës për OZhM-të. Prezantime të ndryshme për OZhM-të, sidomos për referencat kryesore të tyre (avokimin, afirmimin, analizën dhe veprimin) për t'i arritur objektivat, kanë bërë Lulzim Çela dhe Fatmir Haxholli, kurse ekspertja për çështje sociale dhe zvogëlim të varfërisë, Susanne Milcher (nga Bratisllava e Sllovakisë), ka ligjëruar për përvojat e vendeve të BE-së për përfshirjen sociale, duke u përqendruar sidomos për Agjendën e Lisbonës dhe krijimin e kushteve për jetë me dinjitet njerëzor.

Takimin, të cilin e ka drejtuar menaxherja e UNDP-së në mbështetje të Kuvendit, Nora Sahatçiu, e ka përmbyllur koordinatori për zhvillim i agjencive të OKB-së në Kosovë, Freude Muring, i cili ka theksuar se Kosova duhet ta krijojë agjendën e vet të përmbushjes së OZhM-ve dhe është shprehur optimist se Kosova do të bëhet një vend i mirë jete për të gjithë.

Nr	Emërtimi i Ligjit	Nr. i Ligjit	Dt. e Miratimit	Akti dhe data e shpalljes
1	Ligji për Buxhetin e konsoliduar të Kosovës për vitin 2008	03/L-013	15.02.2008	Rreg.UNMIK-2008/13 - 29.02.2008
2	Ligji për statusin , imunitetin dhe privilegjet e misioneve diplomatike, konsullore dhe personelin në Kosovë dhe pranin ndërkombëtare ushtarake si dhe personelin e saj	03/L-033	20.02.2008	Dekreti nr. DL-001-2008, datë 15.06.2008
3	Ligji për shtetësinë e Kosovës	03/L-034	20.02.2008	Dekreti nr. DL-002-2008, datë 15.06.2008
4	Ligji për policinë	03/L-035	20.02.2008	Dekreti nr. DL-003-2008, datë 15.06.2008
5	Ligji për inspektoratin policor të Kosovës	03/L-036	20.02.2008	Dekreti nr. DL-004-2008, datë 15.06.2008
6	Ligji për dokumentet e udhëtimit	03/L-037	20.02.2008	Dekreti nr. DL-005-2008, datë 15.06.2008
7	Ligji për përdorimin e simboleve shtetërore të Kosovës	03/L-038	20.02.2008	Dekreti nr. DL-006-2008, datë 15.06.2008
8	Ligji për zonat e veçanta të mbrojtura	03/L-039	20.02.2008	Dekreti nr. DL-007-2008, datë 15.06.2008
9	Ligji për vetëqeverisjen lokale	03/L-040	20.02.2008	Dekreti nr. DL-008-2008, datë 15.06.2008
10	Ligji për kufijtë administrativ komunal	03/L-041	20.02.2008	Dekreti nr. DL-009-2008, datë 15.06.2008
11	Ligji për Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe shërbimin diplomatik të Republikë së Kosovës	03/L-044	13.03.2008	Dekreti nr. DL-010-2008, datë 15.06.2008
12	Ligji për Ministrinë e Forcës së Sigurisë së Kosovës	03/L-045	13.03.2008	Dekreti nr. DL-011-2008, datë 15.06.2008
Nr	Emërtimi i Ligjit	Nr. i Ligjit	Dt. e Miratimit	Akti dhe data e shpalljes
13	Ligji për Forcën së Sigurisë së Kosovës	03/L-046	13.03.2008	Dekreti nr. DL-012-2008, datë 15.06.2008
14	Ligji për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të komuniteteve dhe pjesëtarëve të tyre në Republikën e Kosovës	03/L-047	13.03.2008	Dekreti nr. DL-013-2008, datë 15.06.2008
15	Ligji për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë	03/L-048	13.03.2008	Dekreti nr. DL-014-2008, datë 15.06.2008
16	Ligji për financat e pushtetit lokal	03/L-049	13.03.2008	Dekreti nr. DL-015-2008, datë 15.06.2008
17	Ligji për themelimin e Këshillit të sigurisë së Kosovës	03/L-050	13.03.2008	Dekreti nr. DL-016-2008, datë 15.06.2008

18	Ligji për Aviacionin Civil	03/L-051	13.03.2008	Dekreti nr. DL-017-2008, datë 15.06.2008
19	Ligji për Prokurorinë Speciale të Republikës së Kosovës	03/L-052	13.03.2008	Dekreti nr. DL-018-2008, datë 15.06.2008
20	Ligji për kompetencat, përzgjedhjen e lëndëve dhe caktimin e lëndëve të gjyqtarëve dhe prokurorëve të EULEX-it në Kosovë	03/L-053	13.03.2008	Dekreti nr. DL-019-2008, datë 15.06.2008
21	Ligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 2002/9 për inspektoratin e punës	03/L-017	29.04.2008	Rreg. UNMIK -2008/34 - 14.06.2008
22	Ligji për përdorimin civil të eksplozivëve	03/L-005	16.05.2008	Dekreti nr. DL-043-2008, datë 24.06.2008
23	Ligji për përkatësitë materiale familjeve të fëmijëve me aftësi të kufizuara të përhershme	03/L-022	16.05.2008	Rreg. UNMIK 2008/33 - 14.06.2008
24	Ligji për agjencinë Kosovare për Intelligjencë	03/L-063	21.05.2008	Dekreti nr. DL-020-2008, datë 15.06.2008
25	Ligji për menaxhimin e integruar dhe kontrollin e kufirit shtetëror	03/L-065	21.05.2008	Dekreti nr. DL-021-2008, datë 15.06.2008
26	Ligji për azil	03/L-066	21.05.2008	Dekreti nr. DL-022-2008, datë 15.06.2008
27	Ligji për Agjencinë Kosovare të Privatizimit	03/L-067	21.05.2008	Dekreti nr. DL-023-2008, datë 15.06.2008
28	Ligji për arsimin në komunat e Republikës së Kosovës	03/L-068	21.05.2008	Dekreti nr. DL-024-2008, datë 15.06.2008
29.	Ligji për festat zyrtare në Republikën e Kosovës	03/L-064	23.05.2008	Dekreti nr. DL-025-2008, datë 15.06.2008
30	Ligji për procedurën përbarimore	03/L-008	02.06.2008	Dekreti nr. DL-042-2008, datë 24.06.2008
Nr	Emërtimi i Ligjit	Nr. i Ligjit	Dt. e Miratimit	Akti dhe data e shpalljes
31	Ligji për Zgjedhjet Lokale në Republikën e Kosovës	03/L-072	05.06.2008	Dekreti nr. DL-026-2008, datë 15.06.2008
32	Ligji për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës	03/L-073	05.06.2008	Dekreti nr. DL-027-2008, datë 15.06.2008
33	Ligji për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës	03/L-074	05.06.2008	Dekreti nr. DL-028-2008, datë 15.06.2008
34	Ligji për themelimin e Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm dhe Zyrës së Auditimit të Kosovës	03/L-075	05.06.2008	Dekreti nr. DL-029-2008, datë 15.06.2008
35	Ligji për Hekurudhat e Republikës së Kosovës	03/L-076	05.06.2008	Dekreti nr. DL-030-2008, datë 15.06.2008

36	Ligji për ndryshimin e rregullores së UNMIK-ut 2006/50 për zgjidhjen e kërkesave lidhur me pronën e paluajtshme private, duke përfshirë pronën bujqësore dhe atë komerciale	03/L-079	13.06.2008	Dekreti nr. DL-031-2008, datë 15.06.2008
37	Ligji për ndryshimin e Ligjit të Kuvendit të Kosovës 2004/9 mbi Rregullatorin e Energjisë	03/L-080	13.06.2008	Dekreti nr. DL-032-2008, datë 15.06.2008
38	Ligji për ndryshimin e rregullores së UNMIK-ut 2005/2 mbi themelimin e Komisionit të Pavarur për Minerat dhe Minerale të Kosovës	03/L-081	13.06.2008	Dekreti nr. DL-033-2008, datë 15.06.2008
39	Ligji për Shërbimin në Forcën e Sigurisë së Kosovës	03/L-082	13.06.2008	Dekreti nr. DL-034-2008, datë 15.06.2008
40	Ligji për shpërbërjen e Trupave Mbrojtëse të Kosovës	03/L-083	13.06.2008	Dekreti nr. DL-035-2008, datë 15.06.2008
41	Ligji për ndryshimin e Rregullores së UNMIK-ut 2005/20 për ndryshimin e Rregullores së UNMIK-ut 2001/35 për Fondin Pensional të Kosovës	03/L-084	13.06.2008	Dekreti nr. DL-036-2008, datë 15.06.2008
42	Ligji për ndryshimin e Rregullores së UNMIK-ut 2003/16 për shpalljen e Ligjit për Telekomunikacion të miratuar nga Kuvendi i Kosovës.	03/L-085	13.06.2008	Dekreti nr. DL-037-2008, datë 15.06.2008
43	Ligji për ndryshimin e Rregullores së UNMIK-ut 2004/49 për veprimtaritë e ofruesve të shërbimeve të ujësjellësit, kanalizimit dhe të mbeturinave	03/L-086	13.06.2008	Dekreti nr. DL-038-2008, datë 15.06.2008
44	Ligji për Ndërmarrjet Publike	03/L-087	13.06.2008	Dekreti nr. DL-039-2008, datë 15.06.2008
45	Ligji për ndryshimin e Rregullores së UNMIK-ut 2008/13 mbi miratimin e Buxhetit të Konsoliduar të Kosovës dhe shpenzimet e autorizuar për periudhën 1 janar deri më 31 dhjetor 2008	03/L-088	13.06.2008	Dekreti nr. DL-040-2008, datë 15.06.2008
46	Ligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për kufijtë administrativ komunal, Ligjit për agjencinë kosovare të privatizimit, ligjit për arsimin në komunat e Republikës së Kosovës, Ligjit për festat zyrtare në Republikën e Kosovës, Ligjit për agjencinë e Kosovës për inteligjencë, Ligjit për azil dhe Ligjit për menaxhimin e integruar dhe kontrollin e kufirit shtetëror	03/L-089	13.06.2008	Dekreti nr. DL-041-2008, datë 15.06.2008
Nr	Emërtimi i Ligjit	Nr. i Ligjit	Dt. e Miratimit	Akti dhe data e shpalljes
47	Ligji për përfitimet e ish zyrtarëve të lartë	03/L-001	19.06.2008	Dekreti nr. DL-044-2008, datë 02.07.2008
48	Ligji për procedurën kontestimore	03/L-006	30.06.2008	Dekreti nr. DL-045-2008, datë 29.07.2008
49	Ligji për vula në institucionet e Republikës së Kosovës	03/L-054	30.07.2008	Dekreti nr. DL-047-2008, datë 07.08.2008
50	Ligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-088 mbi miratimin e Buxhetit të konsoliduar të Kosovës dhe shpenzimeve të autorizuar për periudhën 1 janar deri më 31 dhjetor 2008	03/L-093	30.07.2008	Dekreti nr. DL-046-2008, datë 07.08.2008

Ligjet në rishqyrtim në Komisione Funktionale

Nr	Emërtimi i Ligjit	Nr. i Ligjit	Dt. e Miratimit	Dt. e rishqyrtimit dhe nr. i Ligjit të miratuar	Akti dhe data e shpalljes
1.	Ligji për të drejtat sendore	2004/31	08.09.2004		
2.	Ligji për avokatinë	2004/40	08.09.2004		
3.	Ligji për tubimet publike	2004/43	27.09.2004		
4.	Ligji për lirinë e asociimit në OJQ-të	02/L-6	23.02.2005		
5.	Ligji për ngrohjen qendrore	02/L-49	03.10.2005		
6.	Ligji për ndërprerjen e shtatzënisë	02/L-73	13.07.2006		
7.	Ligji për shpronësimet	02/L-97	08.02.2007		
8.	Ligji për Letërnjoftimin	02/L-119	31.07.2007		
9.	Ligji për gjendjen civile	02/L-125	27.09.2007		
10.	Ligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për rrugët nr. 2003/11	02/L-135	30.10.2007		
11.	Ligji për të drejtat dhe përgjegjësit e deputetit	02/L-144	02.11.2007		
12.	Ligji për plotësimin dhe ndryshimin e Kodit të Përkohshëm Penal të Kosovës	03/L-002	04.04.2008		
13.	Ligji për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit nr. 2003/9 për kooperativat e bujqve	03/L-004	04.04.2008		
14.	Ligji për plotësimin dhe ndryshimin e Kodit të Përkohshëm të Procedurës Penale të Kosovës	03/L-003	29.04.2008		
15.	Ligji për provimin përfundimtar dhe provimin e maturës shtetërore	03/L-018	29.04.2008		
16.	Ligji për Taksën e akomodimit në objektet hoteliere turistike	03/L-027	29.04.2008		
17.	Ligji për procedurën jokontestimore	03/L-007	16.05.2008		

Departamenti për mbështetje ligjore dhe procedurale

25.08.2008



Pamje nga dorëzimi i Deklaratës së Pavarsisë arkivave kombëtare